




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.Nr.319/2022  
Datë: 15 korrik 2022

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Eroll Gashi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, sipas raportit të panelit hetimor Nr.AD/KGJK/07/2022/GJTHPR-AD/GJTHPR.nr.12/22, të datës 6 qershor 2022, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore të mbajtur me 7 dhe 15 korrik 2022, nxjerr:

#### V E N D I M

**Eroll Gashi**, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.10, 2.15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 6, pika 6.2 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

#### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më tutje “Këshilli”), me datë 18 mars 2022 ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimeve disiplinore nga Autoriteti Kompetent/Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë duke pretenduar se Eroll Gashi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, pika 2.10, dhe 2.15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 6, pika 6.2 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Autoriteti Kompetent ka kërkuar nga Këshilli, si organ kompetent të filloj hetimin disiplinor dhe ka propozuar që në rast se vërtetohet se ekziston shkelja disiplinore, t’i shqiptohet njeri nga sanksionet disiplinore të parapara sipas nenit 7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kërkesën për fillimin e hetimeve të cekur me lartë, Autoriteti Kompetent i’a ka bashkëngiitur ankesës disiplinore të palëve nga Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe nga “Betimi për Drejtësi”, lidhur me deklaratimet e gjyqtarit Gashi në media pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 03.02.2022 në lëndën P.nr.664/14 (2019:095071).

Këshilli me vendimin e evidentuar KGJK.nr.129/2022, të datës 24 mars 2022, ka themeluar panelin hetimor për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/07/2022/GJTHPR-AD/GJTHPR.nr.12/22. Paneli hetimor me datë 31 maj 2022 i'a ka paraqitur Këshillit raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar. Pas pranimit të raportit për ta shqyrtuar këtë çështje disiplinore, Këshilli me datë 7 korrik 2022, ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore në të cilën morën pjesë kryesuesi i panelit hetimor gjyqtari Agim Ademi dhe subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Eroll Gashi.

Kryesuesi i panelit hetimor, bazuar në Ligjin Nr.06/l-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, para Këshilli ka deklaruar se seancën dëgjimore e ka mbajtur me datë 20 maj 2022, në të cilën ka prezantua edhe subjekti i hetimit gjyqtari Eroll Gashi. Paneli hetimor ka gjetur fakte të pa kontestuara lidhur me datën e pranimit të lëndës kontestuese P.nr.664/14 (2019:095071) dhe kohën e mbajtjes se seancës së shqyrtimit fillestar me datë 3 shkurt 2022, seancën gjyqësore në të cilën ka monitoruar monitoruesi i IKD-së, dhe i cili kishte publikuar artikullin në portalin Kallxo.com, emisioni “Betimi për Drejtësi” me titull “Urdhërohet të sjellët me forcë ministri ”. Po ashtu për panelin hetimor ka qenë jo kontestuese se gjyqtari Gashi ka qenë i kontaktuar nga gazetaret.

Kjo rrethanë është vërtetuar nga paneli hetimor edhe nga deklaratat e subjektit të hetimit i cili ka deklaruar se me datë 3 shkurt 2022, me fillim prej orës 10:00, ka mbajtur seancën fillestare në çështjen konkrete penale P.nr.664/14. Këtë seancë sipas të gjeturave të panelit e kanë monitoruar monitoruesit nga IKD, të cilët kanë prezantuar në seancë dhe me pas ka publikuar artikullin në portalin Kallxo.com, emisioni Betimi për Drejtësi, me titull “Urdhërohet të sjelljet me forcë ministri ”.

Më tutje, paneli ka gjetur se pas përfundimit të seancës subjekti i hetimit gjyqtari Eroll Gashi, ishte kontaktuar nga Kallxo.com, dhe kishte deklaruar se “Nuk është leshur urdhërese, është gabim kjo”. Me tutje, në këtë deklaram për kallxo.com subjekti i hetimit kishte vazhduar me deklaratë se: siç kam cekur edhe në procesverbal se ” nëse e sjellin arsyetimin që nuk kanë mundur me u paraqit, jam me Covid, ose diçka tjetër, e arsyeton faktin mos me leshu urdhëresë, përndryshe në momentin kur do të caktoj seancë, nëse nuk paraqiten arsyetimet, për mos prezencë në seancë, do të lëshohet urdhëresë për sjellje me detyrim”. Për këtë informacion të dhënë subjekti i hetimit nuk ka pasur autorizim nga kryetarja e gjykatës. Fakti se subjekti i hetimit është kontaktuar nga mediat (Kallxo.com) për të sqaruar nuk e kishte kontestuar as vet subjekti i hetimit gjyqtari Eroll Gashi.

Paneli hetimor, i ka dorëzuar për shqyrtim dhe vendimmarrje KGJK-së këtë raport me faktet dhe provat e mbledhura për të vendos lidhur me pretendimet e Autoritetit Kompetent, se a ka apo nuk ka shkelje disiplinore nga gjyqtari Eroll Gashi, me rastin e deklaratës se dhënë për Kallxo.com.

Gjyqtari Eroll Gashi në seancën dëgjimore të Këshillit të mbajtur me datë 7 korrik 2022, ka deklaruar se nuk është e vërtet që ka qenë i kontaktuar vetëm nga kallxo.com, por është kontaktuar nga të gjitha mediat dhe për të gjitha këto komunikime ka qenë e informuar edhe kryetarja. Më tutje ka deklaruar se e ka njoftuar edhe kryetaren e gjykatës dhe zyrtaren për informim, që ekziston procesverbali i seancës së datë 3 shkurt 2022, dhe gjithçka shihet në procesverbal.

Me tutje, subjekti i hetimit ka deklaruar se me lejen e kryetares subjekti i hetimit ka qenë jashtë gjykatës dhe nuk ka qenë informuar se çfarë kanë shkruar mediat. Ndërkohë, ishte kontaktuar nga disa media, përfshirë edhe Kallxo.com, me ç'rast gjyqtari Gashi kishte deklaruar se nuk është e vërtetë se kishte lëshuar urdhëresë për sjellje me forcë të ministri . Sipas subjektit të hetimit Eroll Gashi, me dhënien e informacionit për Kallxo.com, vetëm ka sqaruar të pavërtetat që ishin publikuar dhe konsideron se më këtë deklaram nuk ka bërë shkelje disiplinore ose shkelje të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë siç ka pretenduar Autoriteti Kompetent. Me dhënien e këtij sqarimi për Kallxo.com, sipas subjektit të hetimit, nuk është zbeh as puna e gjyqësorit dhe as e tij si gjyqtar, dhe as nuk është zbuluar konfidencialiteti i çështjes gjyqësore përkatëse.

Në fjalën përfundimtare kryesuesi i panelit hetimor deklaroi se qëndron pranë raportit me shkrim dhe provave të bashkangjitur.

Subjekti i hetimit gjyqtari Eroll Gashi, në fjalën përfundimtare deklaroi se me dhënien e informacionit për sqarim për mediumin Kallxo.com, nuk ka zbehur punën e gjyqësorit dhe as punën e tij si gjyqtar, dhe lidhur me këtë nuk ka shkelur as Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë, duke kërkuar nga Këshilli qe të lirohet nga përgjegjësia disiplinore.

Për t'i vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore, Këshilli administroi dhe vlerësoi këto prova: Raporti mbi faktet dhe provat e mbledhura të panelit hetimor; Kërkesën për fillimin e hetimeve disiplinore; Transkriptin e seancës dëgjimore të panelit hetimor të mbajtur me datë 20.05.2022; Ankesën e Institutit të Kosovës për Drejtësi dhe Betimi për Drejtësi kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër protokollit 241/2022, e datës 22.02.2022; Ankesën disiplinore në pajtim me Ligjin Nr.06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve drejtuar të Avokati i Popullit nga Kryeredaktor në Betimi për Drejtësi; Komunikatën për Media të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 03.02.2022; Procesverbalin e përpiluar me datë 03.02.2022; Reagimi për redaksinë e “Betimi për Drejtësi”, i datës 15.02.2022; Emaili i kryetares se Gjykatës të datës 03.02.2022; Deklarata e gjyqtarit subjekt i hetimit, i datës 25.02.2022; Procesverbalin e shqyrtimit fillestar të datës 22.02.2019; Procesverbalin e çështjes së të njëjtës datë 04.04.2019 dhe 10.08.2021; Janë shikuar disa flet kthesa; Emaili i dërguar nga Xh.S, i dërguar me datë 04.02.2022 drejtuar gjyqtarit Gashi dhe Aktakuzën e datës 14.03.2022; Njoftimi i zyrtarit dhe disa komunikime të Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Kryetarit të Gjykatës Supreme.

Pas vlerësimit të provave të administruara dhe deklaratës së subjektit të hetimit gjyqtarit Eroll Gashi, Këshilli në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 7 korrik 2022, konstatoi se subjekti i hetimit gjyqtari Eroll Gashi, me rastin e dhënies se deklaratës për Kallxo.com, për të cilin deklaram ka qenë i kontaktuar nga Kallxo.com, nuk ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.10, dhe 2.15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 6, pika 6.2 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Sipas vlerësimit të KGJK-së subjekti i hetimit nuk ka konsumuar shkelje disiplinore, me deklaratën e dhënë për Kallxo.com, i cili medium kishte publikuar artikullin me titull “Urdhërohet të sjellët me forcë ministri Sfeqla”, në rastin ku edhe 12 të akuzuarit tjerë po akuzoheshin për veprime të dhunshme në protestën e 2013-ës. Kjo për shkak se subjekti i hetimit vetëm ka sqaruar për mediumin përkatës se nuk kishte lëshuar urdhëresë për sjellje me detyrim të të akuzuarit .

në rastin penal P.nr.664/14, siç është raportuar.

Ne këtë rast informacioni i dhënë nga subjekti i hetimit vetëm për të sqaruar titullin e publikuar nga portali Kallxo.com, pa dhënë asnjë informacion tjetër me të cilin do të ishte dëmtuar procesi gjyqësor nuk përbën shkelje disiplinore të pretenduar nga Autoriteti Kompetent.

Shkeljet e pretenduara nga Autoriteti Kompetent nuk janë provuar me provat e administruara, të cilat i janë prezantuar Këshillit nga raporti fakt mbledhës i panelit hetimor. Ky raport është vlerësuar si i besueshëm pasi paneli hetimor në mënyrë objektive dhe sipas procedurës së përcaktuar ligjore, ka zhvilluar procesin e hetimit të çështjes dhe konstatimit të fakteve.

Këshilli në seancën për këshillim dhe votim, me shumicë të votave vendosi se gjyqtari Eroll Gashi nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore siç ka pretenduar Autoriteti Kompetent dhe të njëjtin e ka liruar nga përgjegjësia disiplinore.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**  
**KGJK.nr.319/2022, datë: 15 korrik 2022**



Albert ZOGAJ  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- *Albina Shabani Rama, Kryetare Gjykatës Themelore në Prishtinë;*
- *Eroll Gashi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë;*